

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT



PUNIMI I DIPLOMES – MASTER

PREFERENCAT E MARRJES ME AKTIVITETE REKREATIVE SPORTIVE
DHE MËNYRA E JETESËS TEK POPULLATA E KOMUNËS SË
SKENDERAJT

Mentori:
Prof. Dr. Bujar Turjaka

Kandidati:
Ferki Halimi

Prishtinë, 2016

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. QËLLIMI I PUNIMIT	7
3. HIPOTEZAT THEMELORE	9
4. METODOAT E PUNËS	10
4.1.MOSTRA E ENTITETIT	10
4.1. MOSTRA E VARIABLAVE.....	11
4.1.1 Variablat e aplikuara	11
4.2. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE	13
5.1.1. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: Moshë: 35 vjeç>	14
5.1.2. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: Moshë: 31-35.....	21
5.1.3. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: Moshë: 26-30.....	28
5.1.4. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: Moshë: 21-25.....	35
5.1.5. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS Moshë: 18-20.....	42
5.1.6. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS TE MESHKUJT NGA QYTETI DHE VISET RURALE.....	49
5.1.7. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS TE FEMRAT NGA QYTETI DHE VISET RURALE.....	56
5.2 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE THEMELORE.....	63
6. PËRFUNDIMI	64
7. LITERATURA	66

1. HYRJJE

Ruajtja dhe avancimi i shëndeti është një detyrë dhe qëllim shumë i rëndësishëm i jetës njerëzore. Madje, në mënyrë filozofike, shpesh herë njerëzit i referohen konceptit të shëndetit si “një qëllim më vete i ekzistencës”. Në njëfarë mënyre, shëndeti ose mungesa e tij, janë terma të pranishëm pothuajse në të gjitha kontekstet apo dimensionet e ekzistencës së shoqërisë njerëzore. Kjo është veçanërisht e vërtetë për “mirëqenien fizike” të organizmit, së cilës njerëzit i referohen pothuajse çdo ditë në biseda me njëri-tjetrin. Diskutimet rreth komponentëve të tjerë të shëndetit, siç është p.sh. “mirëqenia shpirtërore” apo, “emocionale”, janë më shumë të kufizuara në mjedise intime, apo në grupe të një besimi fetar të caktuar. Problemet e shëndetit mendor janë akoma edhe më shumë të kufizuara në mjedise tepër intime, për vetë karakterin sensitiv të sëmundjeve apo çrregullimeve që lidhen me sferën psiko-emocionale. Sidoqoftë, gjatë jetës së përditshme njerëzit i referohen herë pas here një apo disa komponentëve të shëndetit të tyre në situata dhe në kontekste të ndryshme, duke e konsideruar atë (shëndetin) si kapitalin më të çmuar në jetë. Shëndeti dhe sjellja jone gjeja me e rëndësishme për çdo njeri.

Botëkuptimi se edukimi fizik është pjesë e një shoqërie është një pasqyrë reale dhe e rëndësishëm në zhvillimi e të rinjve. Është mjaftë e rëndësishme dhe domethënëse së shoqëria dhe edukimi fizik janë të ndërlidhur njëra me tjetrin apo mund të themi se shpirtërisht janë të lidhura. E gjithë kjo lidhet me faktin se gjithnjë të rinjët janë nën shoqërimin e bashkëmoshatareve në kryerjen e aktiviteteve të edukimit fizik. Zhvillim i të rinjve është në masë të madhe i varur nga edukimi fizik ashtu edhe gjendja shëndetësore e atyre të rinjve. Edukimi fizik është pjesë e pa ndarë e shkencave shoqërore me çka lenë më kuptuar rëndësinë e shoqërisë në edukimin fizik. Në suazat e zhvillimi të shoqërisë nivel të tillë ka arritur të zhvillohen edhe proceset e metodologjisë së punës në edukimin fizik. Dihet mjaftë mirë se pa ndikim të shoqërisë nuk mund të ec e përparojë as njerëzimi sepse është e ditur se edukimi fizik tek njerëzit është një nga proceset kryesore të zhvillimit të tij. Edukimi fizik tek njerëzit është i rëndësishëm edhe në aktivitete e proceset të tjera të zhvillimi të njeriut. Mirëpo gjeja primare e të gjithëve është se pa shoqërorizim nuk mund të jetë e mundur të bashkëveprojë për jetën e tij të përditshme e të aktiviteteve të edukimit fizik.

Aktiviteti fizik nuk është vetëm marrja me sport, por çdo lëvizje trupore e prodhuar nga muskujt skeletorë, që kërkon shpenzime të energjisë. Ndërkohë, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë për të qenë të shëndetshëm njerëzit kanë nevojë në përgjithësi për të paktën 30 minuta aktivitet fizik të moderuar në pothuajse gjithë ditët e javës ose të paktën në 5 ditë të saj.

Aktiviteti fizik ndikon në rritjen dhe zhvillimin të përgjithshëm të sistemit biopsikosomatik, që nënkupton fisnikrimin e shpirtit pasurimin e mendjes dhe në gjallërimin e trupit të individit të cilët aplikojnë aktivitete fizike .Rritja e shkallës së aktiviteteve fizike ka rol preventiv në sëmundjet kardiovaskulare dhe sistemin muskulo skeletor, parandalimin e goditjes në tru, kancerit dhe ka ndikim pozitiv në mirëqenien e njeriut.

Duke ushtruar zvogëlohet apo reduktohet rreziku nga diabeti, tensioni i lartë i gjakut, sëmundjet e zemrës etj. Aktivitetet lëvizor sportive mbajnë muskujt, kockat dhe tendinet në gjëndje të mirë. Të moshuarve u ndihmon të ndihen më vital, më të levizshëm dhe u përmirëson punën e zemrës. Të ushtruarit e rregullt, minimumi prej 20-30 minuta tre herë në javë mund të forcoj në mënyrë të konsiderueshme sistemin tuaj kardio-vaskulare.

Aktiviteti fizik ka shumë efekte përfituese në drejtim të shëndetit, pavarësisht nga moshja. Njerëzit të cilët bëjnë një jetë të shëndetshme dhe që rregullisht përfshihen në ushtrime, kanë më pak mundësi të zhvillojnë sëmundje kronike, duke përmendur këtu diabetin jo insulin-vartës, sëmundjet kardio-vaskulare, sëmundjet tumorale, ose sëmundjet mendore. Gjithashtu, personat me aktivitet fizik ditor permanent mund të mbajnë peshën e tyre trupore në normat e lejuara po të krahasohen me personat që janë më pak aktiv. Mënyra aktuale e jetesës kërkon aktivitet më të pakët fizik si pasojë e rritjes së përdorimit të makinave, shikimit të televizorit dhe aktivitetit të pakët fizik në shtëpi, për shkak të modernizimit të aparaturave elektronike. Kësaj i shtohen edhe zakone të tjera të mënyrës së jetesës (si pirja e duhanit), shtimi i peshës, të cilat kontribuojnë në rritjen e rrezikut ndaj sëmundjeve kronike. Rekomandohen ushtrimet e përditshme, ecja, vrapimi, kërcimi, noti etj. Njerëzit të cilët kanë futur në rutinën e mënyrës së tyre të jetesës skemën e ushtrimeve, kanë përmirësime të mirëqenies së tyre fiziologjike dhe psikologjike.

Aktiviteti fizik si një fenomen social ndikon pozitivisht në zhvillimin aftësive dhe veçorive antropologjike të njeriut. Përmbajtja e aktivitetit fizik (lloji i ushtrimeve si dhe intenziteti dhe ekstenziteti i ekzekutimit) ndikojnë në ruajtjen dhe avansimin e shëndetit të gjitha moshat, e sidomos te personat me gjëndje më të mirë ekonomike dhe sociale.

Duke pasur parasysh se në shekullin e 21-të gjithë e ma tepër potencohet rëndësia e aktivitetit fizik, si një element thelbësor për shëndetin e njeriut, në rend të parë në parandalimin dhe reduktimin e mbipeshës, sëmundjeve kardiovaskulare dhe respiratore si dhe shumë sëmundjeve tjera, aktiviteti fizik duhet të integrohet në jetën e përditshme si një nevojë natyrore dhe të domosdoshme për të gjithë njerëzit. Aktiviteti fizik ka një efekt të fortë pozitiv në shëndetin e njeriut, sidomos në patogjenezën e sëmundjeve që përbëjnë sindromin metabolik (rezistenca e insulinës, diabeti tip 2, hyperlipidemia, hipertensioni, dhe mbipesha). Ka argumente të forta që flasin se aktiviteti fizik rrit kapacitetet funksionale dhe cilësinë e jetës (Vuori, I. 2004).

Mjedisi sociale të tilla si shkolla, vendi i punës, familja dhe shokët, mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në nivelin e aktivitetit fizik të individit. Duke e kuptuar mundësinë e rrethit dhe pengesat me të cilat përballemi në përpjekje të një jetese më të shëndetshme mund të sigurojmë njohuri të caktuara të nevojshme për përmirësimin e jetesës së shëndetshme.

Ka disa arsye që shkaktojnë mbipeshën. Një ndër to mund të jetë për shkak të çrregullimeve të caktuara hormonale apo çrregullimeve metabolike (Holford, 1999). Megjithatë, para së gjithash, mbipesha ndodh si rezultat i mungesës së aktivitetit fizik dhe diete të parregullt (Guyton dhe Hall, 2008). Domethënë, nëse në organizëm rregullt merren më shumë kalori se mund të harxhojmë, kaloritë e tilla të marra nga ushqimi do të konvertohet në peshë të tepërt në formën e yndyrës së depozituara. Shumica e njerëzve, për ti u larguar mbipeshës, iu nënshtrohen një dietave rraskapitëse (urisë), e cila në të shumtën e rasteve përcillet me pasoja të shumta shëndetësore.

Si pasojë e urisë është humbja e indeve të muskujve që ndihmojnë në harxhimin e yndyrës të tepërt. Mënyra shumë më e mirë që të arrihet deri te qëllimi i dëshiruar është aktiviteti i rregullt fizik. Me ushtrime harxhohen rezervat e energjisë të deponuara si yndyrë, dhe shmanget humbja proteinave të muskujve (Malcko dhe Rađo, 2004). Për këtë arsye, energjia fitohet nga yndyrnat në raport me karbohidratet. Te personat që merren me aktivitete fizike rritet aftësia e shfrytëzimit të yndyrës si burim të energjisë dhe uljen e rrezikut të sëmundjeve të ndryshme të tilla si diabeti. Në mënyrë që të largimit apo harxhimit të dhjamit e tepërt, (Sharkey and Gaskill 2008) sugjerojnë se duhet të kombinohen dy llojet e trajnimit, trajnimi aerob dhe anaerob. Në kohën e sotshme gjithë e më tepër po dëshmohet fakti se

aktiviteti fizik është ndër faktorët kryesor që ndikon në zvogëlimin e peshës trupore dhe në përmirësimin e kualitetit të jetesës. Prandaj për të përcaktuar masën trupore po përdoren aparatura moderne që japin shënime më të sakta dhe të shpejta mbi gjendjen e masës trupore në mënyrë që të programohen aktivitetet fizike.

Fakti se “funksioni ruan funksionin” është i njohur që nga kohërat më të lashta . Qysh para erës sonë babai i medicinës mjeku Hipokrati ka pohuar: “gjerë më tani edhe dembelia tërheq me vete veset e këqija derisa aktiviteti sjell me vete gjallëri, e cila gjithmonë është e orientuar në forcimin e jetës”. Nga shumë faktorë të ndryshëm të cilët veprojnë qoftë në mënyrë pozitive apo negative në zhvillimin fizik, aftësitë funksionale dhe motorike të organizmit si dhe në shëndetin e njeriut, vend të rëndësishëm zen aktiviteti trupor.

Parakusht i rëndësishëm për veprim të dobishëm të aktiviteteve trupore në organizëm është ajo se duhet të jetë drejt e programuar për çdo individ, sepse aktiviteti jo adekuat i tepruar mundë, në vend se të ketë dobi të sjellë deri tek pasojat e dëmshme për organizëm.

Në kushtet e hipokinezisë sistemet e organeve të organizmit kalojnë nëpër shumë ndryshime, të cilat në fund rezultojnë me zhvillimin e proceseve të ndryshme patologjike, veçanërisht në sistemin kardiovaskular. Paralelisht me dukurit e tilla lajmërohen edhe çrregullime në punën e organeve të tjera të rëndësishme siç janë mushkрит, mëlçia, veshkët e tjera. Gjithë e më tepër zvogëlimi i aktiviteteve trupore në jetën e përditshme kushtëzon rëndësin gjithë e më të madhe të aktiviteteve sportive si një ndër faktorët preventiv. Aktivitetet trupore dhe sportive të programuara drejt sjellin deri tek shumë ndryshime pozitive në organizmin e njeriut edhe atë duke e rritur pranimin e oksigjenit, përmirësimin e funksionimit të sistemit kardiovaskular, procese metabolike më të mira, normalizimin e peshës trupore, ndryshime pozitive në sistemin nervor qendror, rritjen e aftësive psikomotorike, funksion më të mire të organeve të frymëmarrjes e tjera. Rezultat i këtyre ndryshimeve pozitive morfologjike, funksionale dhe motorike në organizëm në përgjithësi rezulton me përtrirje biologjike dhe ngritjes së shkallës shëndetësore çka individin e kthen në një rend të njëjtë me të rinj e aftë për punë.

Me fjalë të tjera, lëvizja në përgjithësi, veçanërisht, ushtrimet sistematike, trainingu sportive, dhe aktivitetet gjatë lojës, të harmonizuara me moshën e individit, janë faktor të rëndësishëm të zhvillimit trupor, funksional dhe motorik. Në esencë, nga pikëpamja

antropologjike, faktorët endogjen dhe ekzogjen me anë të bashkëveprimit rregullojnë karakteristikat e njeriut, sjelljet dhe zhvillimin e tij.

Faktorët që kanë ndikim pozitiv dhe negativ në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të njeriut janë të shumtë, mirëpo në këtë punim do ta hulumtojmë vetëm nivelin e njohurive mbi ndikimin e aktiviteteve fizike si faktor i rëndësishëm i cili ka ndikim të caktuar në stilin e të jetuarit si dhe ndikon në disa nga nënsistemet e organizmit tonë e me këtë edhe në organizëm në përgjithësi, konkretisht në zhvillimin morfologjik, motorik dhe funksional të rinisë.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Aktivitetin fizik rekreativ lidhur me Shëndetin ose ndikimin e aktivitetit fizik në shëndetin e njeriut e shohim në aspektin:

Përbërjes së trupit në aspektin e raportit në mes masës yndyrore dhe asaj jo yndyrore. Aktivitetin fizik rekreativ ndikon në zvogëlimin e masës yndyrore dhe rritjen e masës jo yndyrore. Rëndësia e ndërtimit të trupit për sportet nuk është e definuar në tërësi si parakusht për arritjen e rezultateve në sportet kulmore.

Sistemi kardioavaskular - Aftësia funksionale është e kushtëzuar me raportin ndërmjet aftësive të lindura (trashëguese) dhe të fituara për përshtatje. Aftësia për adaptim është veçori e cila manifestohet si proces biologjik vetëm pas ndikimit e cila kryhet në homeostazën dinamike të organizmit dhe rezulton me përgjigjeje aktive specifike të organizmit në këto ndikime. Në hapësirën e karakteristikave antropologjike në lëmin e kineziologjis vende të rëndësishëm zen hulumtimet që kanë të bëjnë me njohjen e aftësive funksionale të organeve të brendshme si dhe atyre motorike. Autor të shumtë kanë vërtetuar se aftësia e muskujve për tu kontrahuar shpejt ndërpritet nëse pengohet sjellja e materieve energjetike në muskuj. Këtu shihet rëndësia e aftësive funksionale gjatë ekzekutimit të aktiviteteve fizike rekreative.

Me anë të këtij punimi do të bëjmë përpjekje të japim një pasqyrë të qartë të jetës aktive rekreative, shprehive individuale të jetesës dhe disa dukurive negative (duhani, alkooli, droga) në popullatën e qytetit të Skenderajt. Qëllimi i këtij punimi është që në bazë të rezultateve të hulumtimit të inkurajohet më shumë popullata e këtij qyteti për angazhim më të madh në aktivitetet rekreative sportive dhe në largimin e barrierave që pengojnë realizimin e këtij qëllimi, duke filluar nga ngritja e vetëdijes mbi ndikimin e aktiviteteve fizike në organizmin e njeriut, deri te angazhimi i tyre në rregullimin e infrastrukturës sportive pastaj në zvogëlimin i kohës së lirë pranë aparateve elektronike: (TV, radio, mobil, fb); në luftimin e dukurive negative (alkooli, duhani, droga), në rritjen e vetëdijes rreth promovimit të shëndetit përmes rekreacionit dhe lëvizjes etj.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të problemit të hulumtimit dhe në përputhje me qëllimin formulohen dhe parashtrihen këto hipoteza:

H₀₁ – Presim se vlerat e fituara tek gjinia mashkullore dhe femërore do të kenë dallime statistikisht të vlefshme.

H₀₂ – Presim se vlerat e fituara në mes gjinisë mashkullore dhe femërore do të kenë dallime statistikisht të vlefshme në favor të gjinisë mashkullore.

H₀₃ -- Presim se vlerat e fituara tek popullata e qytetit dhe viseve rurale te meshkujt do të kenë dallime statistikisht të vlefshme në favor të popullatës së qytetit.

H₀₄ -- Presim se vlerat e fituara tek popullata e qytetit dhe viseve rurale te femrat do të kenë dallime statistikisht të vlefshme në favor të popullatës së qytetit.

4. METODOAT E PUNËS

4.1.MOSTRA E ENTITETIT

Popullata nga e cila do të merret mostra për qëllimet e këtij hulumtimi është definuar si popullatë e rastësishme e qytetareve të Skenderajt.

Mostra e të anketuarve ka përfshirë 400 qytetarë të rastësishëm të Komunës së Skenderajt, domethënë, nga 200 të anketuar për të dy gjinitë. Mostra e të anketuarve në aspektin e kategorive të moshës është ndarë në pesë nëngrupe.

Grupin e të moshuarave prej 18-20 vjeçare nga 40 të anketuar të dy gjinive.

Grupin e të moshuarave prej 21-25 vjeçare nga 40 të anketuar të dy gjinive.

Grupin e të moshuarave prej 26-30 vjeçare nga 40 të anketuar të dy gjinive.

Grupin e të moshuarave prej 31-35 vjeçare nga 40 të anketuar të dy gjinive.

Grupin e të moshuarave mbi 35 vjeçare 40 të anketuar të dy gjinive.

Popullata nga e cila është zgjedhur mostra për të krahasuar mënyrën e jetesës në fshat dhe qytet, është popullatë e kësaj komune, ku janë përfshirë 400 të anketuar (200 nga qyteti dhe 200 nga fshati) të dy gjinive dhe moshave të ndryshme të ndarë në pesë grupe.

4.1. MOSTRA E VARIABLAVE

Si instrument i hulumtimit është përdor pyetësi, posaçërisht i konstruktuar për këtë hulumtim. Në pjesën ku ka të bëjë në vlerësimin e shprehive të jetesës të anketuarave si indikator ose tregues kryesor janë të dhëna përshkrimet aktiviteteve të mëposhtme të cilat konsiderohen si shprehje të jetesës: Pirja e cigareve, konsumimi i alkoolit, ushqimi i rregullt, gjumi i rregullt dhe marrja me aktivitete rekreative sportive.

4.1.1 Variablat e aplikuara

Pyetjet e pyetësit:

I - merrem me aktivitete rekreative sportive:

1. i/e rregullt (së paku 3 here në javë)
2. kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)
3. asnjë herë

II - mendimi i të anketuarave mbi shfrytëzimin e sportit në qytet : Pyetja-organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Skenderaj do të jetë e dobishme:

1. po
2. nuk jam i/e sigurt
3. jo

III – Qëndrimi i të anketuarave mbi pjesëmarrjen aktive në aktivitetet rekreative sportive. Pjesëmarrja aktive në aktivitetet rekreative sportive:

1. po
2. ndoshta
3. jo

IV – Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor:

1. deri 10 cigare

2. 10-20 cigare
3. ma tepër se 20 cigare në ditë
4. nuk e konsumoj.

V – Konsumimi i alkoolit

1. rregullisht (çdo ditë)
2. kohë pas kohe (nganjëherë në javë)
3. nuk e konsumoj.

VI – Shprehitë në ushqim në shujta:

1. 1 here në ditë
2. 2 here në ditë
3. 3 here në ditë
4. 4 here në ditë

VII – Sa orë gjumë bëni:

1. 5 orë
2. 6 orë
3. 7 orë
4. 8 orë
5. 9 orë
6. 10 orë

4.2. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara, do të aplikohen metodat e përpunimit të rezultateve të cilat mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për realizimin e qëllimit.

Rezultatet të cilat janë fituar nga anketimi janë përpunuar me anë të paketës së programit SPSS. Analizat statistikore të cilat janë shfrytëzuar me qëllim të vërtetimit të hipotezave kanë qenë deskriptive.

Karakteristikë në këtë hulumtim paraqet aplikimi i metodës deskriptive për përpunimin dhe interpretimin e të dhënave. Të dhënat janë mbledhur me ndihmën e pyetësorit nga të anketuarit.

Rezultatet që janë fituar duke përdorur instrumentet hulumtuese janë të paraqitura në përqindje, në grafikone, tabela dhe tekstualisht.

Të gjitha të dhënat e marra nëpërmjet pyetësorit u analizuan sipas detyrave të përcaktuara nga ky hulumtim.

Nga hapësira e statistikës krahasuese për dy grupet e trajtuara në këtë punim është përdorur procedura diskriminative (χ^2 -Hi- test katrori) e cila aplikohet për të shqyrtuar dallimin në mes të frekuencave të vërejtura dhe pritura.

5.1.1. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: Moshë: 35 vjeç>

Tabela 1. Pyetëtori: “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, për të anketuarit e moshës mbi 35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femërore.

Merrem me aktivitete rekreative sportive	36> M	36> F	Σ
regullisht (së paku 3 here në javë)	18	9	27
Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)	14	14	28
Asnjë here	8	17	25
Σ	40	40	80
χ^2	$\chi^2= 3.80$ df: 2 p= 0.149	$\chi^2= 2.450$ df: 2 p= 0.194	$\chi^2=9.96$ df: 2 p= 0.083

Në tabelën 1 është e parashtruar pyetja e “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, për të anketuarit e moshës mbi 35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femërore. Në çdo shoqëri apo shtet bëhen programe rreth zhvillimit të fushave të caktuara të atij shteti, pra edhe të sportit si veprimtari shoqërore që është e orientuar në ngritjen e vetëdijes për një nivelit më të lartë shëndetësor të popullatës.

Në pyetjen e të anketuarve “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, 18 nga të anketuarit e gjinisë mashkullore merren rregullisht (së paku 3 here në javë), kurse te gjinia femërore shumica e tyre nuk merren asnjëherë ose 17 prej tyre. Edhe pse ekziston një dallim i theksuar në përgjigjet e dhëna, nuk ekziston një dallim i rëndësishëm në mes atyre që merren rregullisht dhe atyre që nuk merren asnjëherë. Në pyetjen e të anketuarave “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, në mes të anketuarave nuk ekziston një dallim i rëndësishëm as brenda grupit të ndarë sipas gjinisë as në mes gjinive. Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket kësaj pyetjeje ($\chi^2=9.96$; $p<0.083$) (tabela 1).

Tabela 2. Pyetësori: “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë do të jetë i dobishme”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.

II Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Skenderaj do të jetë i dobishme:	36> M	36> F	Σ
Po	36	38	74
Nuk jam i sigurt	0	2	2
Jo	4	0	4
Σ	40	40	80
χ^2	$\chi^2= 58.40$ df: 2 p= 0.000	$\chi^2= 32.40$ df: 2 p= 0.000	$\chi^2=2.76$ df: 2 p= 0.251

Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në çdo qytet të Kosovës do të ishte i dobishëm në ruajtjen dhe avancimin e shëndetit për popullatën e të gjitha moshave dhe gjinive, sidomos e asaj mbi moshën 36 vjeçare. Në pyetjen e të anketuarve “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Skenderaj do të jetë i dobishme”, 38 të anketuar të gjinisë femërore dhe 36 të gjinisë mashkullore përgjigjen me “Po”, çka ekziston një dallim i rëndësishëm në mes atyre që mendojnë se: Po – do të jetë i dobishëm dhe atyre që janë përgjigjur “Nuk jam i sigurt”. Te femrat dhe meshkujt ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit në pyetjen: “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë do të jetë i dobishme”. Nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket kësaj pyetjeje ($\chi^2=2.76$; $P<0.251$) (tabela 2).

Është i rëndësishëm fakti se të anketuarit e gjinisë mashkullore dhe femërore kanë njohuri mbi rëndësinë e organizimit të aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Skenderaj. Kjo edhe reflektohet me pjesëmarrje të popullatës së Skenderajt në aktivitete rekreative sportive.

Tabela 3. Pyetësi: “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femërore.

III. Qëndrimi i të anketuarave mbi pjesëmarrjen aktive në aktivitetet rekreative sportive: A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive:	36> M	36> F	Σ
Po	36	36	72
Nuk jamë i sigurt	0	3	3
Jo	4	1	5
Σ	40	40	
χ^2	$\chi^2=56.46$ df: 2 P= 0.000	$\chi^2= 57.95$ df: 2 p= 0.000	$\chi^2=2.14$ df: 2 P= 0.341

Në tabelën 3 është paraqitur Pyetësi: “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femërore. Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në çdo qytet të Kosovës do të ishte i dobishëm në ruajtjen dhe avancimin e shëndetit për popullatën e të gjitha moshave dhe gjinive, sidomos e asaj mbi moshën 36 vjeçare. Në pyetjen e të anketuarve “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive”, 36 të anketuar nga të anketuarve të dy gjinive përgjigjen se “Po”, çka ekziston një dallim i rëndësishëm në mes atyre që mendojnë se: Po – marr pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive dhe atyre që mendojnë “Nuk jam i sigurt” dhe atyre me përgjigje “Jo”. Te femrat dhe meshkujt ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit në pyetjen: “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive”. Nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket kësaj pyetjeje ($\chi^2=2.14$; $P<0.341$) (tabela 3).

Të anketuarit e gjinisë mashkullore dhe femërore marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive. Kjo edhe reflektohet me pjesëmarrje shumë të madhe të popullatës së Skenderajt në aktivitete rekreative sportive.

Tabela 4. Pyetësori: “Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femërore.

IV. Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor	36> M	36> F	Σ
deri 10 cigare	0	8	8
10-20 cigare	14	3	17
ma teper se 20 cigare në ditë	7	0	7
nuk e konsumoj	19	29	48
Σ	40	40	80
χ^2	$\chi^2=20.60$ df: 3 p= 0.000	$\chi^2=51.40$ df: 3 p= 0.000	$\chi^2=18.84$ df: 3 p= 0.000

Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor i duhanit do të ishte i dëmshëm për shëndetin e popullatës e të gjitha moshave dhe gjinive. Në pyetjen e të anketuarve “Konsumimi ditor i cigareve”, të anketuarit e kësaj moshe kanë përgjigje të ndryshme gati në tri pyetjet, atyre që konsumojnë nga 10-20 cigare, atyre që konsumojnë ma tepër se 20 cigare në ditë dhe atyre që nuk e konsumoj nuk ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit. Në pyetjen e të anketuarave “Konsumimi ditor i cigareve”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njëjta në tri pyetjet, atyre që konsumojnë nga 10-20 cigare, atyre që konsumojnë ma tepër se 20 cigare në ditë dhe atyre që nuk e konsumoj ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 29 femra të anketuara nuk e konsumojnë duhanin. Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor brenda grupeve si dhe në mes femrave dhe meshkujve sa i përket konsumimit të duhanit, femrat më pak e konsumojnë duhanin ($\chi^2=18.84$; $P<0.000$) (tabela 4).

Tabela 5. Pyetësori: “Frekuenca e konsumimit të alkoolit. Konsumimi ditor”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.

V. Konsumimi i alkoolit	36> M	36> F	Σ
rregullisht (çdo ditë)	7	0	7
kohë pas kohë (nganjëherë në javë)	14	1	15
nuk e konsumoj	19	39	58
Σ	40	40	100
χ^2	$\chi^2=5.45$ df: 2 p= 0.065	$\chi^2=74.15$ df: 2 p= 0.000	$\chi^2=20.97$ df: 2 p= 0.000

Frekuenca e konsumimit të alkoolit është e paraqitur në tabelën 5. Konsumimi ditor i alkoolit i tepruar do të ishte i dëmshëm për shëndetin e popullatës e të gjitha moshave dhe gjinive. Në pyetjen e të anketuarve “Konsumimi ditor i alkoolit”, të anketuarit e kësaj moshe, meshkujt kanë përgjigje të njëjta në tri pyetjet, atyre që konsumojnë rregullisht alkool, atyre që kohë pas kohë (nganjëherë në javë) dhe atyre që nuk e konsumoj dhe se nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor brenda grupit $\chi^2=5.45$, df: 2, p= 0.065.

Në pyetjen e të anketuarave “Konsumimi ditor alkoolit”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njëjta në tri pyetjet, atyre rregullisht (çdo ditë) që konsumojnë alkool, atyre që konsumojnë kohë pas kohë (nganjëherë në javë) dhe atyre që e konsumoj ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 39 prej të anketuara nuk e konsumojnë alkoolin dhe ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave $\chi^2=74.15$, df: 2, p= 0.000.

Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket konsumimit të alkoolit, femrat më pak e konsumojnë alkoolin ($\chi^2=20.97$; p<0.000).

Tabela 6. Pyetësori: “Shprehitë në ushqim në shujta”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femërore.

VI. Shprehitë në ushqim në shujta	36> M	36> F	Σ
1 here në ditë	0	0	0
2 here në ditë	12	24	36
3 here në ditë	21	15	36
4 here në ditë	7	1	8
Σ	40	40	80
χ^2	$\chi^2=23.40$ df: 3 p= 0.000	$\chi^2=40.20$ df: 3 p= 0.000	$\chi^2=7.18$ df: 3 p= 0.027

Frekuenca e shprehisë në ushqim në shujta është e paraqitur në tabelën 6. Konsumimi ditor i ushqimit shumë herë në ditë dhe vlera kalorike të mëdha do të ishte i dëmshëm për shëndetin e popullatës e të gjitha moshave dhe gjinive, sepse do të kemi një mbipeshë te popullata që është ndër faktorët e rrezikshmëris për shumë sëmundje.

Në pyetjen e të anketuarve “Shprehitë në ushqim në shujta”, të anketuarit e kësaj moshe kanë përgjigje të njëjt në dy pyetjet, atyre që konsumojnë rregullisht 2 here ne ditë, dhe atyre që 3 here ne ditë dhe se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor brenda grupit sepse 21 veta , domethënë shumica e tyre konsumojnë ushqim 3 here ne ditë $\chi^2=23.40$, df: 3, p= 0.000.

Në pyetjen e të anketuarave “shprehitë në ushqim në shujta”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njëjta në katër pyetjet, atyre që marrin ushqimin 1 here ne ditë, atyre që marrin 2 here ne ditë atyre që marrin 3 here ne ditë dhe atyre që marrin 4 here ne ditë ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 24 prej tyre e femrave të anketuara marrin shujta 2 here ne ditë $\chi^2=40.20$, df: 3, p= 0.000

Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket shprehive në ushqim në shujta sepse femrat marrin 2 here ne ditë ($\chi^2=7.18$; p<0.027).

Tabela 7. Pyetësori: “Sa orë gjumë bëni”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femërore.

VII. Sa orë gjumë bëni	36> M	36> F	Σ
5 orë	5	0	5
6 orë	9	3	12
7 orë	11	12	13
8 orë	12	15	17
9 orë	3	10	13
10 orë>	0	0	0
Σ	40	40	80
χ^2	$\chi^2=17.00$ df: 5 p= 0.004	$\chi^2=31.70$ df: 5 p= 0.000	$\chi^2=8.20$ df:4 p= 0.084

Frekuenca e e asaj se „Sa orë gjumë bëni „, është e paraqitur në tabelën 7. Njeriu ka nevojë për gjum sepse nevojat ditore janë 7-8 ore gjumë.

Në pyetjen e të anketuarëve “Sa orë gjumë bëni”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njëjtë, atyre që bëjnë gjumë 7 orë në ditë dhe atyre që bëjnë gjumë 8 orë në ditë dhe të anketuarve që bëjnë gjumë deri 9 orë dhe ekziston një dallim në mes veti $\chi^2=17.00$, df: 5, p= 0.004.

Në pyetjen “Sa orë gjumë bëni”, të anketuarat e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njëjta në gjashtë përgjigje, atyre që bëjnë gjumë 5 orë, atyre që bëjnë 6 orë gjumë, atyre që bëjnë gjumë 7 orë, atyre që bëjnë gjumë 8 orë, atyre që bëjnë gjumë 9 orë dhe atyre që bëjnë gjum mbi 10 orë, ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 15 femra të anketuarave bëjnë gjumë 8 orë ne ditë $\chi^2=31.70$, df: 5, p= 0.000.

Nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket pyetjes e të anketuarve për dy gjinitë “Sa orë gjumë bëni”, ($\chi^2=8.20$; p=0.084).

5.1.2. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: Moshë: 31-35

Tabela 8. Pyetëtori: “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, për të anketuarit e moshës 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femërore

I – Merrem me aktivitete rekreative sportive	31-35 M	31-35 F	Σ
regullisht (së paku 3 here në javë)	15	10	25
Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)	14	13	27
Asnjë here	11	17	28
Σ	40	40	80
χ^2	$\chi^2= 0.65$ df: 2 p= 0.722	$\chi^2= 1.85$ df: 2 p= 0.396	$\chi^2=1.53$ df: 2 p= 0.313

Aktivitetet rekreative sportive në këtë moshë kanë një rëndësi të veçantë për shëndetin e njeriut. Kjo periudhë manifestohet me zvogëlimin e aktiviteteve fizike dhe konsumimin e ushqimit të njëjtë, çka krijohet një jo baraspeshë në mes energjisë së shfrytëzuar dhe kalorive të deponuara.

Në pyetjen e të anketuarve “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, nga të anketuarve merren kohë pas kohe (kryesisht vikendeve), asnjëherë dhe rregullisht tregon se nuk ekziston një dallim i rëndësishëm në mes atyre që merren rregullisht dhe atyre që nuk merren asnjëherë $\chi^2= 0.65$, df: 2, p= 0.722.

. Në pyetjen e të anketuarve “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, në mes të anketuarve nuk ekziston një dallim i rëndësishëm $\chi^2= 1.853$, df: 2, p= 0.396

Gjithashtu nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket kësaj pyetjeje ($\chi^2=1.53$; df: 2, p=0.313) (tabela 8).

Tabela 9. Pyetëtori: “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë do të jetë i dobishme”, për të anketuarit e moshës 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femërore.

II – Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Skenderajt do të jetë i dobishme:	31-35 M	31-35 F	Σ
Po	38	37	75
Nuk jamë i sigurt	2	2	4
Jo	0	1	1
Σ	40	40	400
χ^2	$\chi^2=68.60$ df: 2 p= 0.000	$\chi^2= 63.05$ df: 2 p= 0.000	$\chi^2=0.25$ df: 2 p= 0.882

Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në çdo qytet të Kosovës do të ishte i dobishëm në ruajtjen dhe avancimin e shëndetit për popullatën e të gjitha moshave dhe gjinive, sidomos e asaj mbi moshën 30-35 vjeçare. Në pyetjen e të anketuarve “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Skenderajt do të jetë i dobishme”, 38 të anketuar përgjigjen se “PO”, çka ekziston një dallim i rëndësishëm në mes atyre që mendojnë se: “Nuk jam i sigurt” dhe atyre që janë përgjigjur “JO”. $\chi^2=68.60$, df: 2, p= 0.000

Te femrat, 37 femra shprehen se “PO”, dhe ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit në pyetjen: “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Skenderaj do të jetë i dobishme”. $\chi^2= 63.05$, df: 2, p= 0.000.

Nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket pyetjes “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Skenderaj do të jetë i dobishme”. ($\chi^2=0.25$; p= 0.882) (tabela 9).

Tabela 10. Pyetësi: “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive”, për të anketuarit e moshës 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femërore.

III. Qëndrimi i të anketuarave mbi pjesëmarrjen aktive në aktivitetet rekreative sportive. Pjesëmarrja aktive në aktivitetet rekreative sportive	31-35 M	31-35 F	Σ
Po	38	37	75
Nuk jamë i sigurt	2	2	4
Jo	0	1	1
Σ	40	40	800
χ^2	$\chi^2=68.60$ df: 2 p= 0.000	$\chi^2= 63.05$ df: 2 p= 0.000	$\chi^2=0.25$ df: 2 p= 0.882

Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në qytetin e Skenderajt do të ishte i dobishëm në ruajtjen dhe avancimin e shëndetit për popullatën e të gjitha moshave dhe gjinive, sidomos e asaj mbi moshën 31-35 vjeçare.

Në pyetjen e të anketuarve “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive”, 38 të anketuar përgjigjen se “PO”, 2 të anketuar përgjigjen “Nuk jam i sigurt” dhe asnjë me përgjigjen se “JO”, çka ekziston një dallim i rëndësishëm në mes atyre që mendojnë se: Po – marr pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive, atyre që mendojnë “Nuk jam i sigurt” dhe atyre me përgjigje “Jo” $\chi^2=68.60$, df: 2, p= 0.000.

Te femrat ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit në pyetjen: “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive” $\chi^2= 63.05$, df: 2, p= 0.00038 sepse 37 të anketuara përgjigjen se “PO”.

Nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket kësaj pyetjeje: “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive” ($\chi^2=0.25$; p= 0.882) (tabela 10).

Tabela 11. Pyetësori: “Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor”, për të anketuarit e moshës 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.

IV. Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor	31-35 M	31-35 F	Σ
deri 10 cigare	3	7	10
10-20 cigare	14	2	16
ma teper se 20 cigare në ditë	0	0	0
nuk e konsumoj	23	31	54
Σ	40	40	80
χ^2	$\chi^2=33.40$ df: 3 p= 0.000	$\chi^2=61.40$ df: 3 p= 0.000	$\chi^2=9.37$ df: 2 p= 0.009

Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor i duhanit do të ishte i dëmshëm për shëndetin e popullatës e të gjitha moshave dhe gjinive.

Në pyetjen e të anketuarëve “Konsumimi ditor i cigareve”, të anketuarit e kësaj moshe kanë përgjigje gati të njëjtë në tri pyetjet, atyre që konsumojnë nga 10-20 cigare, atyre që konsumojnë ma tepër se 20 cigare në ditë dhe atyre që nuk e konsumoj ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit $\chi^2=33.40$, df: 3, p= 0.000 sepse shumica prej tyre nuk e konsumojnë.

Në pyetjen e të anketuarave “Konsumimi ditor i cigareve”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njejta në tri pyetjet, atyre që konsumojnë nga 10-20 cigare, atyre që konsumojnë ma teper se 20 cigare në ditë dhe atyre që nuk e konsumoj ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 31 femra të anketuara nuk e konsumojnë duhanin. $\chi^2=61.40$, df: 3, p= 0.000

Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket konsumimit të duhanit. ($\chi^2=9.37$; p= 0.009) sepse shumica e meshkujve e konsumojnë (tabela 11).

Tabela 12. Pyetësi: “Frekuenca e konsumimit të alkoolit. Konsumimi ditor”, për të anketuarit e moshës 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femërore.

V. Konsumimi i alkoolit	31-35 M	31-35 F	Σ
rregullisht (çdo ditë)	3	0	3
kohë pas kohe (nganjëherë në javë)	13	1	14
nuk e konsumoj	24	39	63
Σ	40	40	800
χ^2	$\chi^2=16.55$	$\chi^2=74.15$	$\chi^2=13.08$
	df: 2	df: 2	df: 2
	p= 0.000	p= 0.000	p= 0.001

Frekuenca e konsumimit të alkoolit është e paraqitur në tabelën 12. Konsumimi ditor i alkoolit i tepruar do të ishte i damshëm për shëndetin e popullatës e të gjitha moshave dhe gjinive.

Në pyetjen e të anketuarve “Konsumimi ditor i alkoolit”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njejt në tri pyetjet, atyre që konsumojnë rregullisht alkool, atyre që kohë pas kohë (nganjëherë në javë) dhe atyre që nuk e konsumoj dhe se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor brenda grupit. $\chi^2=16.55$, df: 2, p= 0.000

Në pyetjen e të anketuarave “Konsumimi ditor i alkoolit”, të anketuarat e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njejt në tri pyetjet, atyre rregullisht (çdo ditë) që pijnë alkool, atyre që konsumojnë kohë pas kohë (nganjëherë në javë) dhe atyre që nuk e konsumoj ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 39 prej femrave të anketuara nuk e konsumojnë alkoolin. $\chi^2=74.15$, df: 2, p= 0.000

Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket konsumimit të alkoolit, $\chi^2=13.08$, df: 2, p= 0.001 sepse 39 prej femrave të anketuara nuk e konsumojnë alkoolin.

Tabela 13. Pyetësi: “Shprehitë në ushqim në shujta”, për të anketuarit e moshës mbi 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femërore.

VI. Shprehitë në ushqim në shujta	31-35 M	31-35 F	Σ
1 here në ditë	0	0	0
2 here në ditë	15	20	35
3 here në ditë	25	19	41
4 here në ditë	0	1	1
Σ	40	40	80
χ^2	$\chi^2=45.00$ df: 3 P= 0.000	$\chi^2=36.20$ df: 3 p= 0.000	$\chi^2=1.02$ df: 2 p= 0.590

Frekuenca e shprehis në ushqim në shujta te moshja 31-35 vjeçare është e paraqitur në tabelën 13. Konsumimi ditor i ushqimit shumë herë në ditë dhe vlera kalorike të mëdha do të ishte i damshëm për shëndetin e popullatës e të gjitha moshave dhe gjinive, sepse do të kemi një mbipeshë te popullata që është ndër faktorët e rrezikshmeris për shumë sëmundje.

Në pyetjen e të anketuarve “Shprehitë në ushqim në shujta”, të anketuarit e kësaj moshe janë përgjigjur 2 here ne ditë 15 te anketuar dhe atyre 3 here ne ditë me 25 të anketuar dhe se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor brenda grupit. $\chi^2=45.00$, df: 3, P= 0.000

